



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 911/ Prot.  
2

Tiranë më 7 . 4 .2022

**VENDIM**

Nr. 10 , datë 05 . 04 . 2022

**“PËR**

**MIRATIMIN PARAPRAK TË PROJEKT BUXHETIT TË VITIT 2022 TË  
UNIVERSITETIT TË TIRANËS”**

Referuar Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, pika h, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 115/2021, date 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, VKM-së Nr.75 datë 12.02.2018 “Për miratimin e modeli të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, Udhëzimit të përbashkët Nr. 20 datë 20.09.2019 të MAS dhe MFE “Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, pasi mori në shqyrtim project - Buxhetin e hartuar nga Administratori i UT-së mbi propozimet e njësive kryesore, Senati Akademik në mbledhjen e datës 05.04.2022:

**VENDOSI:**

1. Miratimin paraparak të Projekt-Buxhetit vjetor të Universitetit të Tiranës për vitin 2022 si më poshtë vijon:
  - Miratimin e detajimit të kuotave të buxhetit të konsoliduar (Grant mësimdhënie, të ardhura UT) sipas formularit nr.1 bashkëlidhur.
  - Miratimin e detajimit të shpenzimeve operative sipas formularit nr.2 bashkëlidhur.
  - Miratimin e detajimit të investimeve sipas listës me objektet sipas formularit nr.3 bashkëlidhur.
  - Miratimin e numrit të planifikuar të punonjësve sipas formularit nr.4; 4,1 bashkëlidhur.
  - Miratimin e ndryshimeve strukturore sipas formularit nr.5 bashkëlidhur.
2. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim në përputhje me nenin 49, pika 1, gërma c, ç të ligjit nr. 80/2015.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**PROF. DR. ARTAN HËXHA**